

LIGJ
Nr.7424, datë 14.11.1990

PËR ARBITRAZHIN SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministave

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PARIME TËËRGJITHSHME

Neni 1

Arbitrazhi shtetëror ka për detyrë të zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet pasurore të kompetencës së tij, të mbrojtë ligjshmërinë socialiste në dobi të plotësimit të planit e të kontratave, të regjimit të kursimit, të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave. Gjithashti, ka për detyrë të ngrejë në një shtet më të lartë përgjegjësinë vetjake të drejtuesve ose punonjësve të tjerë në lidhje me ekzekutimin e detyrimeve kontraktore e jashtëkontraktore, si dhe kryerjen e detyrave të tjera ekonomike.

Arbitrazhi shtetëror ndikon, nëpërmjet shqyrtimit të çështjeve, në forcimin e lidhjeve e të bashkëpunimit të ndërmarrjeve, të institucioneve e kooperativave me personat juridikë ose fizikë të huaj a shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, që kryejnë investime ose zhvillojnë veprimtari ekonomike në RPSSH.

Neni 2

Në veprimtarinë e tij arbitrazhi shtetëror bazohet në ligje dhe në akte të tjera nënligjore të nxjerra nga organet kompetente.

Neni 3

Në zgjedhjen e çështjeve arbitrazhi shtetëror është i pavarur dhe vendos vetëm në bazë të ligjit.

Organet e arbitrazhit shtetëror përgjigjen dhe japin llogari para organeve më të larta të tyre, organeve që i kanë emëruar, si dhe drejtpërsëdrejti para masave.

Neni 4

Arbitrazhi shtetëror, në zgjedhjen e çështjeve konkrete nuk e merr parasysh, që nga çasti i nxjerrjes së tij, aktin juridik i cili bën ndryshime në kundërshtim me ligjin, në planin e prodhimit dhe të shpërndarjes, si dhe në kushtet e kontratës.

KREU II
ORGANIZIMI I ARBITRAXHIT SHTETËROR

Neni 5

Organet e arbitrazhit janë:

Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave dhe arbitrashi shtetëror pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve.

Neni 6

Arbitrazhi shtetëror pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit përbëhet nga kryetari zëvendësi i tij dhe një numër arbitrash e ndihmësarbitreash të emëruar nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit. Për emërimin dhe shkarkimin e kryetarit të arbitrazhit merret paraprakisht pëlqimi i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe një numër arbitrash e ndihmësarbitrash të emëruar nga Këshilli i Ministrave.

Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave kontrollin veprimtarinë e organeve të tjera të arbitrazhit shtetëror dhe merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të punës së tyre.

Neni 7

Në organet e arbitrazhit punojnë si arbitra, si rregull, ata që kanë arsim juridik, kurse kryetarët duhet të caktohen juristë.

KREU III JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT E ARBITRAZHIT SHTETËROR

Neni 8

Arbitrazhi shtetëror zgjidh:

Mosmarrëveshjet pasurore parakontraktore kur detyrimi për lidhje kontrate buron nga akti i planifikimit, mosmarrëveshjet pasurore që lindin nga shkelja e kontratave, si dhe ato që lindin nga shkelja e mosmarrëveshjeve të tjera të përfunduara me telefakse, telegrame ose telekse ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve e kooperativave, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet këyre të fndit dhe personave juridikë ose fizikë të huaj a shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, që kryejnë investime ose zhvillojnë veprimtari ekonomike në RPSSH.

Neni 9

Arbitrazhi shtetëror pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit shqyrton të gjitha çështjet, me përjashtim të atyre që hyjnë në juridiksionin e Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave zgjidh mosmarrëveshjet:

a) Kur njëra nga palët është ministri ose institucion qendror.

b) Kur vlefte e padisë për mosmarrëveshjet parakontraktore është mbi 60 mijë lekë dhe mbi 400 mijë lekë për mosmarrëveshje të tjera.

Edhe kur vlefte e padisë është më e vogël, me kërkesën e njëres Palë, Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave pranon për shqyrtim mosmarrëveshe ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve ose kooperativave me qendër veprimtarie në rrethe të ndryshme.

c) Kur njëra nga palët është ndërmarrje me pjesëmarrje të kapitalit të huaj, person juridik a fizik i huaj ose shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH, që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH dhe pala tjetër është person juridik shqiptar me seli në RPSSH, kur në kontratë ose në marrëveshje tjetër me shkrim kanë pranuar zgjidhjen e çështjes nga arbitrazhi.

Arbitrazhi shtetëror pranë Këshillit të Ministrave ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim çdo çështje që është në kompetencë të arbitrazhit të rrethit.

KREU IV RREGULLAT E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE NË ARBITRAZH

Mosmarrëveshjet merren në shqyrtim nga arbitrazhi shtetëror:

- a) Me kërkesën e palëve.
 - b) Me kërkesën e ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, të prokurorit dhe të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.
- Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve, kur njëra nga palët është ndërmarrje me pjesëmarrje të kapitalit të huaj ose person juridik a fizik i huaj, fillon vetëm me kërkesën e palëve.

Neni 12

Padia ngrihet në arbitrazhin e rrethit, ku është qendra e veprimtarisë së ndërmarrjes, institucionit, organizatës shoqërore ose kooperativës së paditur.

Me marrëveshje të palëve me shkrim në kontratë, padia mund të ngrihet edhe në arbitrazhin e një rrethi tjetër.

Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave me kërkesën e palëve mund të transferojë shqyrtimin e një çështjeje nga një rreth në tjetrin, kur provat ndodhen atje dhe çështja mund të zgjidhet shpejt.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces, para ngritjes së padisë, janë të detyruar të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim dhe përmbushjen vullnetare të detyrimit.

Neni 13

Kërkesëpadia duhet të përmbajë emrin e arbitrazhit, objektin, shkaqet, provat, si dhe të gjitha dokumentet provuese, si kontrata, procesverbalet, faturat, fletëanalizat, fletëngarkesat, provat që tregojnë se janë bërë rakordimet dhe të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, si dhe vërtetimin se është njoftuar ana e paditur për kërkesëpadinë.

Kërkesëpadia, që nuk iplotëson kushtet e sipërpërmendura, mbetet pa veprim dhe për këtë arbitrazhi lajmëron paditësin, duke i caktuar një afat për të plotësuar të metat. Kur paditësi nuk iplotëson tëmetat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet e paraparaqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet.

Neni 14

a) Arbitrazhi shtetëror shqyrton mosmarrëveshjet në kolegji të përbërë nga një arbitër dhe dy ndihmës arbitra, të cilët janë të drejta të barabarta në zgjidhjen e çështjes.

b) Për çështje të rëndësishme, me vendim të kreytarit të arbitrazhit, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve mund të bëhet nga një kolegji i përbërë nga tre arbitra ose dy arbitra e tre ndihmësarbitra.

c) Përbërja e kolegjit dhe arbitrat që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeje nga Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, kur njëra nga të dy palët është ndërmarrje me pjesëmarrje të kapitalit të huaj ose person juridik apo fizik i huaj a shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH, caktohen sipas vullnetit të palëve, të shprehur në kontratë ose në marrëveshje tjetër me shkrim.

Neni 15

Në shqyrtimin e çështjes nuk mund të marrin pjesë si arbitra e ndihmësarbitra personat që janë ndërmjet tyre apo me pjesëmarrësit në proces bashkëshortë ose gjini e afërt; ata që kanë marrë pjesë si ekspertë ose si arbitra më parë në këtë çështje, si dhe kur ka rrethana të tjera, për shkak të të cilave lindin dyshime për paanësinë e arbitrit ose të ndihmësarbitrit.

Në raste të tilla palët kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e arbitrit dhe kërkesa zgjidhet me shumicë votash nga arbitrat e tjerë të kolegjit. Kur votat janë të barabarta, arbitri quhet i përjashtuar.

KREU V AFATET E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE

Neni 16

Afatet e shqyrtimit të çështjeve nga arbitrazhit shtetëror janë:

- a) për mosmarrëveshjet parakontraktore deri në 10 ditë;
- b) për mosmarrëveshjet kontraktore deri në 30 ditë;
- c) për mosmarrëveshjet, kur njëra palë është person juridik ose fizik i huaj a shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH, që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH, deri në 2 muaj.

Afatet fillojnë nga dita e pranimit të kërkesëpadisë në arbitrazh.

KREU IV VENDIMET E ARBITRAZHIT

Neni 17

Arbitrazhi shtetëror, pasi ka dëgjuar shpjegimet e palëve dhe të personave të tjerë të interesuar dhe ka shqyrtuar dokumentet e nevojshme vendos, sipas rastit, kushtet për lidhjen e kontratës, detyrimin për pagimin e kushtit disiplinor ose të gjobës, shpërblimin e dëmit dhe fitimin e munguar, kryerjen e punimeve, dorëzimin e objektit, plotësimin e detyrimit ose refuzimin e kërkesës, si dhe për shpenzimet e gjykimit në arbitrazh.

Vendimi jepet me shumicë votash dhe nënshkruhet nga arbitrat e ndihmësarbitrat.

Neni 18

Ministritë a institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ndërmarrjet, institucionet dhe kooperativat, qofshin ose jo palë në shqyrtimin e çështjeve, detyrohen të japin shpjegime, të paraqesin dokumente dhe çdo material tjetër të nevojshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sa herë që do të kërkohen nga arbitrazhi shtetëror.

Kur punonjësit e ndërmarrjeve, të institucioneve dhe të kooperativave ose persona të tjerë nuk paraqiten pa arsye dhe shpjegimet e tyre kanë rëndësi, shqyrtimi i çështjeve shtyhet dhe ata mund të gjobiten deri në 100 lekë nga kolegji që shqyrton çështjen.

Në seancë proceverbali ku pasqyrohen dokumentet e nevojshme shkresore dhe shpjegimet e palëve, të ekspertëve e të personave të tjerë të thirrur nga arbitrazhi.

Neni 19

Kur për zgjidhjen e çështjes nevojiten mendime të specialistëve, arbitrazhi shtetëror cakton ekspertë, të cilët, kur nuk paraqiten pa arsye, mund të gjobiten, nga kolegji që shqyrton çështjen deri në 100 lekë.

Neni 20

Arbitrazhi që shqyrton çështjen, ka për detyrë të njierrë shkaqet e moslidhjes së kontratës ose të mospërbushjes së saj dhe , kur vëren shkelje të ligjit, të disiplinës së planit e të kontratave, qoftë edhe nga veprime të kryera nga palë jokontraktuese, por që kanë lidhje me detyrimet kontraktore në shqyrtim, gjobit deri në masën e një page mujore drejtuesit e ndërmarrjeve, të institucioneve e të kooperativave dhe personat e tjerë që thirren për gjykim e që me veprimet ose mosveprimet e tyre kanë penguar lidhjen në afat të kontratave ose përmbushjen e tyre, si dhe kërkon marrjen e masave disiplinore ose materiale.

Neni 21

Kur gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve del se kanë përgjegjësi edhe punonjës të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, të ministrive a të institucioneve të tjera qendrore që nuk janë palë, organet e arbitrazhit kanë të drejtë të gjobitin deri në një pagë punonjësit e tyre, si dhe të

kërkojnë marrjen e masave disiplinore a materiale ndaj tyre.

Organet e arbitrazhit të rrethit, kur lind nevoja për marrjen e masave për drejtuesit e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe punonjësit e ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, çështjen ia përcjellin Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, për ta shqyrtuar në tërësi. Për kryetarin e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, ministrin ose drejtorin e institucionit tjetër qendror i paraqitet kërkesë për masë materiale a disiplinore Kryesisë së Këshillit të Ministrave nga Arbitrazhi Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Organet e arbitrazhit, kur gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve vërejnë furnizime jashtë planit pa plotësuar detyrimet kontraktore, mosplotësim pa shkak të detyrimeve ndaj eksoortit, dëmtim të objekteve të reja për shkak të mosmarrjes në dorëzim nga investitori brenda afateve të caktuara në kontratë, mosplotësim të asortimentit si pasojë e përdorimit pa kriter të lëndës së parë, veç masave të tjera, kanë të drejtë të gjobitin personat përgjegjës deri në dy paga.

Neni 23

Organet e arbitrazhit kanë të drejtë që në shqyrtimin e çështjes të vënë detyra brenda një afati të caktuar për përmbushjen e detyrimit. Vendimi i arbitrazhit në këtë rast është i detyrueshëm për zbatim.

Kur detyrimi nuk përmbushet brenda afatit, pa shkaqe të përligjura, me vendim të arbitrazhit personat përgjegjës gjobiten deri në dy paga, si dhe bëhet kërkesë për masë disiplinore, gjer në largimin e tyre nga puna.

Neni 24

Personat fajtorë, për shkeljen e rregullave të parashikuara në ligj, para se të gjobiten, thirre dhe dëgjohen nga kolegji që shqyrton çështjen. Mosparaqitja pa shkaqe të përligjura nuk pengon shqyrtimin e çështjes.

Kur masa e gjobës është më e madhe se 400 lekë, personi i gjobitur ka të drejtë që, brenda 10 ditëve nga dhënia e vendimit të ankohet në mbledhjen e përgjithshme të arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Kur palët ose njëra prej tyre, në mosmarrëveshje, janë ndërmarrje me pjesëmarrje të kapitalit të huaj, persona juridikë a fizikë të huaj ose shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, nuk zbatohen rregullat e parashikuara nga nenet 18, 19, 20, 21, 22, 23 e 24 të këtij ligji.

Neni 26

Kur gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve del se persona të veçantë kanë përgjegjësi penale, arbitrazhi bën kallëzim në organet kompetente.

Neni 27

Vendimi i arbitrazhit shtetëror duhet të përmbajë emrin e organit që e ka shqyrtuar çështjen, kohën dhe vendin e dhënies së vendimit, emrin e ndërmarrjes, të institucionit, të organizatës shoqërore ose të kooperativës që është paditës ose i paditur, si dhe të pjesëmarrësve të tjerë, objektin e mosmarrëveshjes, kërkesat përfundimtare të pjesëmarrësve në proces, bazën ligjore për zgjidhjen e çështjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

KREU VII
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT, ANKIMI NDAJ TYRE DHE KËRKESA PËR
MBROJTJE LIGJSHMËRIE

Neni 28

Vendimi i arbitrazhit shtetëror është i formës së prerë; vihet në zbatim në bazë të urdhrat të tij dhe është i detyrueshëm për Bankën e Shtetit, organet financiare e organet e tjera, si dhe për zyrat e përmbarimit.

Kur palët ose njëra prej tyre, në favor të së cilës është dhënë vendim, janë ndërmarrje me pjesëmarrje të kapitalit të huaj, persona juridikë a fizikë të huaj ose shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH që kryejnë investime ose zhvillojnë veprimtari ekonomike të RPSSH, ekzekutimi i vendimit bëhet prej tyre me anë të depozitimit në organet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 29

Kur njëra nga palët në kontratë është ndërmarrje me pjesëmarrje të kapitalit të huaj ose person juridik a fizik të huaj apo shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH dhe të drejtën e ankimit është parashikuar në kontratë, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e dhënies së vendimit në mbledhjen e përgjithshme të arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Kundër vendimeve të kolegjeve të arbitrazhit pranë komitetit ekzekutiv të rrethit, si dhe të kolegjeve të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe kryetari i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, kanë të drejtë t'i bëjnë kërkesë për mbrojtje ligjshmërie mbledhjes së përgjithshme të arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, brenda tre muajve nga data e dhënies së vendimeve.

Ndaj vendimeve të arbitrazhit, kur njëra nga palët është ndërmarrje me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj person juridik a fizik i huaj ose shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH, që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH, nuk lejohet të ushtrohet kërkesë për mbrojtjen ligjshmërie.

Neni 30

Mbledhja e përgjithshme e arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari e arbitrat dhe ka këto kompetenca:

- Të nxjerrë udhëzime të detyrueshme për organet e arbitrazhit që i përkasin praktikës së punës së tyre;
- Të shqyrtojnë ankimin dhe kërkesat për mbrojtje ligjshmërie kundër vendimeve të kolegjeve të arbitrazhit të rretheve e të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.
- Të marrë në shqyrtim raporte statistikore e analiza që i shërbejnë përmirësimit të punës së arbitrazhit.

Neni 31

Mbledhja e përgjithshme e arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, kur shqyrton kërkesa për mbrojtje ligjshmërie ose ankime ndaj vendimeve, ka të drejtë të pezullojë, të ndryshojë, të lërë në fuqi, të prishë vendimin e arbitrazhit dhe ta shqyrtojë në themel çështjen ose t'ia dërgojë për shqyrtim një kolegji tjetër.

Pezullimi vendoset kur:

- a) Personi juridik me akt të organit kompetent, ka mbaruar.
- b) Çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër civile, penale ose administrative.

Pezullimi vazhdon derisa të paraqitet për të marrë pjesë në çështje pala që hyn me të drejtat e të zëvendësuarit, si dhe pasi të jenë zhdukur pengesat që kanë shkaktuar pezullimin.

Neni 32

Shkaqet për prishjen e vendimit janë, kur:

- a) Arbitrazhi ka dhënë vendim në mungesë të kontratës a të marrëveshjes ose vendimi është bnazuar në një marrëveshje a kontratë të pavlefshme.
- b) Kolegji i arbitrazhit nuk është formuar në rregull.
- c) Çështja është zgjidhur në mungesë të njëres palë dhe kjo nuk ka pasur dijeni për ditën e shqyrtimit.
- ç) Vendimi nuk është mbështetur në prova ose në ligj.

KREU VIII MASAT PARANDALUESE TË ARBITRAZHIT

Neni 33

Organet e arbitrazhit kanë të drejtë e detyrë të bëjnë studime e analiza për zbatimin e ligjit e të kontratave që i shërbejnë ngritjes së nivelit të punës së tyre dhe ndihmojnë në përmirësimin e rritjes së veprimtarisë së organeve ekonomike për njohjen dhe zbatimin e ligjeve në fushën e prodhimit e të shpërndarjes. Ato:

- Shqyrtojnë çështjet më të rëndësishme në qendra pune e prodhimi.
- Njihen me praktikën e zbatimit e ligjeve gjatë përfundimit të kontratave, si dhe marrin pjesë në mbledhje të kolegjiujmeve e të këshillave teknikë, kur shqyrtohen probleme të shkeljes së disiplinës së planit ose të kontratave, të ngritura prej tyre.
- Kërkojnë me vendim të veçantë nga organet përkatëse marrjen e masave disiplinore, materiale ose administrative ndaj punonjësve që kanë shkelur ligjet, si dhe mënjanimin e mosmarrëveshjeve pasurore.
- Njihen me projektaktet që kanë të bëjnë me përmirësimin e metodologjisë së planifikimit, me kontratat, me furnizimin materialo-teknik, me mirëadministrimin e pasurisë e me disiplinën e punës, si dhe me marrëveshjet paraprake dhe projektkontratat e statutet, kur njëra nga palët është ndërmarrje me pjesëmarrje të kcapitalit të huaj, person juridik a fizik i huaj ose shqiptar me seli jashtë territorit të RPPSH që zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH dhe bëjnë vërejtje për plotësimin e tyre.

Neni 34

Drejtuessit e ministrive a të institucioneve të tjera qendorore, të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, të ndërmarrjeve, isntitucioneve e kooperativave detyrohen të shqyrtojnë dhe të kthejnë përgjigje brenda një muaji lidhur me kërkesat e arbitrazhit për masa parandaluese.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Këshilli i Ministrave, në zbatim të këtij ligji, cakton rregulla themelore për organizimin, kontrollin si dhe procedurën për azgjdhjen e mosmarrëveshjeve dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.

Neni 36

Çështjet që ndodhen në shqyrtim pranë gjykatës së rrethit ose në Gjykatën e Lartë deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të përfundohen nga këto organe. Në rast se gjykatat e rretheve nuk kanë filluar shqyrtimin e çështjeve, t'ia dërgojnë këto menjëherë arbitrazhit prkatës.

Neni 37

Dekreti nr.5009, datë 10.11.1972, shfuqizohet.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi më 1.1.1991.

SEKRETARI I PRESIDIMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA